

Mbrojtja e të dhënave personale dhe dhënia e pëlqimit

Në mënyrë që të vijoni regjistrimin për marrjen e këtij produkti kërkohet që të plotësohen në formën e aplikimit online të dhenat personale si: emër, mbiemër, gjinia, shtetësia, datëlindje, numer telefoni fiks & celular, adresë banimi, adresë email-i, shteti, qyteti, emri i punedhësit, numer telefoni punedhësit, te ardhurat neto, te ardhura të tjera.

Mbrojtja e të dhënave personale

Banka e konsideron mbrojtjen e privatësisë dhe të të dhënave tuaja personale si çështje shumë të rëndësishme dhe është e përkushtuar të zbatojë kuadrin ligjor në mbrojtje dhe respektim të tyre, ashtu siç edhe përcaktohet, Ligji Nr. 9887 datë 10.03.2008 'Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale', i ndryshuar si dhe aktet e tjera nënligjore në zbatim të tyre, si dhe Rregulloren Europiane për Mbrojtjen e të Dhenave Personale.

Informacioni i detajuar për kategorinë e të dhënave që përpunohen, qëllimet, kriteret e përpunimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale gjenden në faqen e internetit të Bankës <https://www.raiffeisen.al/alb/> menuja “Mbrojtja e të dhënave personale” në linkun <https://www.raiffeisen.al/alb/about/pages/mbrojtja-e-te-dhenave/>

Përdoruesi konfirmon plotësimin dhe vërtetësinë e informacionit të dhënë dhe deklaron gjithashtu se ka plotësuar në mënyrë korrekte dhe të vërtetë të tërë informacionin të kërkuar.

Dhënie Pëlqimi

Me plotësimin e aplikimit online, përdoruesi deklaron se jep miratimin e tij për përpunimin e mëtejshëm të informacionit të dhënë prej tij nga Raiffeisen Bank, vetëm për qëllimin e përdorimit të produktit Karte Krediti për të cilin përdoruesi ka deklaruar vullnetarisht të dhënat e tij personale. Në çdo moment pasi përdoruesi të ketë dhënë vullnetarisht informacionin e kërkuar në këto fusha specifike, këtij të fundit i lind e drejta që, nëpërmjet një kërkesë pranë Raiffeisen Bank, të aksesojë këto të dhëna si dhe të kërkojë, bllokimin, korrigjimin apo fshirjen e tyre në përputhje me parashikimet e bera në Ligjin nr9887 dt 10.03.2008 “për mbrojtjen e të dhënave Personale” dhe GDPR.

Nese ju terhiqeni nga ky aplikim, para se te klikoni butonin “Apliko”, duke mos dashur te vijoni me tej me regjistrimin, ne kete rast te dhenat tuaja personale nuk ruhen nga Banka. Nese pas regjistrimit vendosni te cregjistroheni nga marrja e produktit, ju mund te dergoni nje kerkese per ç’regjistrim ne adresen info@raiffeisen.al. Pasi te ç’regjistroheni nga perdorimi i ketij sherbimi/produkti, te dhënat tuaja personale do te ruhen vetem ne kuader te marredhenies qe keni si klient me Banken.

Per çdo ankese lidhur me mbrojtjen e te dhenave personale, mund t’i drejtoheni “Komisionerit per te Drejten e informimit dhe Mbrojtjen e te dhenave Personale”.